



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr: 4782 Prot.

Berat më, 30.07.2026

NJOFTIM

**“PËR ORGANIZIMIN E DËGJESËS PUBLIKE NË LIDHJE ME MIRATIMIN E
PLANIT SOCIAL 2027-2030”**

Bazuar në Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030, në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe në Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” është përcaktuar qartësisht detyrimi i Bashkisë për të identifikuar nevojat për shërbimet e kujdesit shoqëror, për t’i planifikuar dhe ngritur këto shërbime. Aktualisht bashkia Berat është në proces hartimi të Planit Social 2027-2030 ku përgatitja e një plani të tillë për bashkinë e cila është një aktorë kryesorë për planifikimin, organizimin, financimin, ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor. Për këtë arsye, kemi përgjegjësinë për të vlerësuar nevojat sociale të komunitetit, për të hartuar dhe zbatuar plane sociale vendore dhe për të siguruar aksesin e grupeve vulnerabël në shërbime të përshtatshme dhe cilësore.

Në vijim të procesit të konsultimit me publikun ju ftojmë të merrni pjesë në dëgjesën publike, ditën e mërkurë datë 05/08/2026 ora 11:00 pranë ambienteve të bashkisë Berat, sala e konferencave.

Gjatë takimit të dëgjesës publike do të bëhet prezantimi i Planit Social 2026-2030.

KRYETARI

Eryin GECA

